

Politikat e Privatësisë

Për faqen zyrtare: www.kpa.al

Kolegji i Posaçëm i Apelit

A. Hyrje

1. Privatësia e vizitorëve të faqes sonë zyrtare: www.kpa.al është shumë e rëndësishme për ne dhe jemi të angazhuar për ta mbrojtur atë. Ky dokument mbi politikën e privatësisë shpjegon mënyrën tonë të veprimit me të dhënat personale të individëve në faqen zyrtare të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “KPA”) për kategoritë si më poshtë:

- a) në rastet e denoncimeve për subjektet e rivlerësimit kalimtar, në rubrikën “Denonco”;
- b) në rastet e vizitorëve në rubrikat e faqes zyrtare të KPA-së.

2. Të dhënat personale të përdorura në përputhje me kushtet e kësaj politike, kur vizitohet faqja jonë për herë të parë, përdoren si të tilla çdo herë që vizitoni faqen tonë të internetit.

3. KPA-ja i përdor informacionet tuaja vetëm në ushtrim të funksionit në bazë të ligjit nr. 84, datë 30.08.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe për të vijuar komunikimin lidhur me denoncimet tuaja.

4. Stafit i KPA-së i nënshtrohet detyrimit ligjor për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit, nëpërmjet nënshkrimit të Deklaratës së Konfidencialitetit, që në fazën e rekrutimit të tij. KPA-ja në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse ofron udhëzime e trajnime stafit, për një kuptim dhe zbatim adekuat të përgjegjësive të tyre në respektimin e sigurisë së informacionit.

B. Ligjshmëria

Ky dokument është hartuar në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, të ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” dhe të rregullores së KPA-së “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”.

C. Si vepron me të dhënat tuaja personale?

“TË DREJTAT TUAJA”

1. Të dhënat e personave denoncues për subjektet e rivlerësimit dhe personat e tretë

- Mbështetur në nenin 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe

sigurinë e të dhënave personale” në KPA, i cili nëpërmjet “Formularit të Denoncimit nga Publiku”, në rubrikën “Denonco”, mbledh të dhëna personale për denoncuesit, të tilla si: emër/atësi/mbiemër/e-mail/nr. personal i identifikimit /adresa/ telefon/cel/, si dhe të dhëna për subjektin e rivlerësimit kalimtar, ndaj të cilit adresohet denoncimi, të tilla si: emër/mbiemër/gjykata/prokuroria ku ka punuar, si dhe persona të tretë që mund të përmenden në denoncim me të dhënat personale si më sipër.

Të drejtat dhe interesat e personave që denoncojnë, mbrohen automatikisht në mënyrë të besueshme, të efektshme dhe të përshtatshme, sipas standardeve të parashikuara në ligjin nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

-Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit publikohen në faqen zyrtare të institucionit. Në tekstin e vendimit çdo e dhënë personale i nënshtrohet procesit të anonimizimit, duke u koduar me simbolin e yjeve “{***}”, në përputhje me parashikimet e rregullores së KPA-së “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”.

-Kërkesat për informacion dhe përgjigjet e tyre publikohen në faqen zyrtare të KPA-së dhe i nënshtrohen procesit të anonimizimit, për sa është e nevojshme, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar.

Të dhënat e mësipërme mbledhen, ruhen dhe nuk mund të përdoren për qëllime të tjera të ndryshme nga ai i grumbullimit të tyre, të parashikuar në nenin 7 të rregullores së KPA-së “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”.

2. Të dhënat e vizitorëve në faqen tonë të internetit

KPA-ja, nëpërmjet faqes zyrtare të internetit www.kpa.al, u vjen në ndihmë vizitorëve të saj, të interesuar, duke prezantuar, kuadrin ligjor që aplikohet në ushtrimin e funksionit të institucionit, njoftime lidhur me proceset gjyqësore që zhvillohen në Kolegj, vendimet e KPA-së, procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informacion apo denoncim, informacion mbi adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim dhe denoncimeve, si dhe rubrika të tjera të cilat aksesohen në faqen zyrtare të KPA-së. Qëllimi i mbledhjes së këtyre informacioneve për vizitorët e faqes sonë, është për efekte statistikore dhe studimi mbi përdorimin e faqes, gjithnjë pa i bërë ata të identifikueshëm.

D. Siguria e sistemit elektronik

KPA-ja përdor një teknologji bashkëkohore për të mbrojtur sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale të subjekteve. Ambienti ku ruhen server-at dhe pajisje të tjera survejohen me kamera dhe mund të aksesohen vetëm nga stafi i KPA-së përgjegjës për teknologjinë e informacionit.

Kjo politikë privatësie mbulon vetëm faqen tonë të internetit dhe jo faqet e tjera të lidhura me të.

E. Si të na kontaktoni

“Për pyetje dhe modifikime”

Për çdo pyetje/kërkesë për informacion apo ankesë në lidhje me politikën tonë të privatësisë, mund të na kontaktoni në adresën:

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”; Nr. 3, Tiranë

E-mail: info@kpa.al

E-mail: sibora.dedej@kpa.al

Ndryshimi apo përditësimi i kësaj politike privatësie do të njoftohet po në këtë faqe.